



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I FARMACISË

PROGRAMI I INTEGRUAR I CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT
“Master i Shkencave” në “Farmaci”

Historiku

Historia e arsimit të lartë mjekësor shqiptar daton me themelimin e Institutit të Lartë Mjekësor, me Vendim nr. 381, datë 07.06.1952 të Këshillit të Ministrave, dhe programi i parë që u hap në këtë institut ishte programi i studimit për përgatitjen e mjekëve të përgjithshëm. Ky institucion ishte një nga pesë fakultetet themeluese të Universitetit të Tiranës në vitin 1957, duke marrë statusin e Fakultetit të Mjekësisë me Vendim nr. 197, datë 20.05.1957 të Këshillit të Ministrave dhe vazhdoi punën duke ofruar dy degë: degën e Mjekësisë së Përgjithshme dhe në vitin 1959, degën e Stomatologjisë. Aktualisht Fakulteti i Mjekësisë është njësi kryesore e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i cili është krijuar me Vendim Nr. 48, datë 23.01.2013 “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)” të Këshillit të Ministrave.

Programi i integruar i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” i ofruar nga Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë (FM), Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT) është programi i parë dhe i vetëm në fushën farmaceutike që ofrohet prej rreth 65 vitesh në arsimin e lartë publik në vendin tonë.

Programi i studimit është hapur për herë të parë në vitin akademik 1960-1961 me dekret të Kuvendit Popullor Nr. 241, dt. 02.06.1960. Sipas këtij Dekreti u vendos hapja e Studimeve Universitare për Farmaci pranë Fakultetit të Mjekësisë.

Me riorganizimin e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës dhe themelimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Farmacisë, FM si pjesë e UMT dhe është vlerësuar dhe akredituar institucionalisht për herë të parë në vitin 2017 nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë (ASCAL) në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë për një periudhë 5-vjeçare dhe është riakredituar në vitin 2022 me një kohëzgjatje maksimale prej 6 vitesh.

Programi i studimit është ofruar pa ndërprerje që nga viti 1960 nga Departamenti i Farmacisë i cili është përgjegjës për organizimin, ofrimin, zbatimin dhe përmirësimin e tij. Ky program, për shkak të natyrës së dyfishtë të disiplinave përbërëse, të cilat i përkasin jo vetëm fushës së shkencave natyrore por edhe të shkencave mjekësore, fillimisht është ofruar nga Departamenti i Farmacisë si pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës UT (duke u shkëputur përfundimisht nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës në vitin 2004) dhe më pas si pjesë e Fakultetit të Mjekësisë UMT.

Me miratimin e Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 (LAL 80/2015) dhe kuadrit ligjor në fuqi, departamenti ka kryer përshtatjet e programit të studimit si dhe të veprimtarisë akademike, kërkimore dhe administrative në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Fakulteti i Mjekësisë, përbëhet nga 16 njësi bazë/departamente

1. Departamenti i Morfologjisë
2. Departamenti i Lëndëve Bio-Mjekësore dhe Eksperimentale
3. Departamenti i Sëmundjeve të Brendshme
4. Departamenti i Laboratorëve
5. Departamenti i Semiologjisë Klinike dhe Imazherike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I FARMACISË

6. Departamenti i Sëmundjeve të Zemrës dhe Enëve të Gjakut
7. Departamenti i Sëmundje Infektive, Sëmundjeve të Lëkurës
8. Departamenti i Kirurgjisë
9. Departamenti i Orl-Okulistikës
10. Departamenti i Pediatriisë
11. Departamenti i Neuro-Shkencës
12. Departamenti i Obstretik-Gjinekologjisë
13. Departamenti i Anatomisë Patologjike, Mjekësisë Ligjore
14. Departamenti i Mjekut të Familjes dhe i Sëmundjeve Profesionale
15. Departamenti i Farmacisë
16. Departamenti i Shëndetit Publik

Strukturat akademike të Fakultetit të Mjekësisë mbështeten nga strukturat administrative të miratuara nga organet kolegjiale. Rolet dhe përgjegjësitë e organeve kolegjiale dhe autoriteteve drejtuese të fakultetit janë të përcaktuara qartë në aktet rregullative të institucionit dhe fakultetit.

Fakulteti i Mjekësisë garanton autonomi të plotë dhe liri akademike në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, në përputhje me Statutin e UMT-së, përkatësisht për përzgjedhjen e stafit, për ofrimin e programeve të studimit, për ngritjen dhe konsolidimin e bashkëpunimeve me institucione të tjera të arsimit të lartë apo organizata të tjera, për të pranuar studentë dhe për të menaxhuar burimet në pronësi të ligjshme të institucionit.

I.TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

a. Për institucionin:

Nr.	Të dhënat për aktet themelore	
1	Hapja e Institutit të Lartë Mjekësor Licencimi i Universitetit të Mjekësisë Tiranë	VKM Nr. 381, datë 07.06.1952 (ILM) VKM Nr. 48, Datë 23.01.2013 (UMT)
2	Akreditimi i institucionit	Vendim i Bordit të Akreditimit Nr.69, datë 21.09.2017 Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 03 datë 27.01.2023
2	Hapja e njësisë kryesore ku ofrohet programi	VKM Nr. 381, datë 07.06.1952 (ILM) Vendim nr. 197, datë 20.05.1957 (Fakulteti i Mjekësisë)

b. për programin e studimit:

Nr.	Tabela e të dhënave për programin e studimit	
1	Institucioni	Universiteti i Mjekësisë Tiranë, institucion publik i arsimit të lartë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I FARMACISË

2	Njësia kryesore/bazë që ofron programin	Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë
3	Akti i licencimit të programit	Dekret të Kuvendit Popullor Nr. 241, dt. 02.06.1960
4	Titulli i programit të studimit:	Program i integruar i Ciklit të dytë “ Master i Shkencave në Farmaci”
5	Cikli i studimit:	Cikli II i integruar
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	300 Kredite
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	PO
13	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
14	Aktivizimi i programit të studimit	Që nga viti 1960

II. MISIONI DHE OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Misioni dhe objektivat e programit të integruar të ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” janë në përputhje me misionin dhe vizionin e UMT.

Misioni i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” është formimi i profesionistëve farmacistë me njohuri të thelluara shkencore, profesionale dhe praktike në shkencat farmaceutike, kimike dhe mjekësore, të aftë për të ushtruar profesionin e farmacistit në përputhje me standardet bashkëkohore të kujdesit farmaceutik, etikës profesionale dhe nevojave të sistemit shëndetësor.

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit (Departamenti i Farmacisë) është e angazhuar që përmes këtij programi të krijojë dhe të përhapë njohuri në fushën farmaceutike, duke ndërthurur mësimdhënien teorike me praktikën laboratorike, profesionale dhe klinike, si dhe duke nxitur të mësuarit aktiv, arritjet, integritetin, kreativitetin, kërkimin shkencor, inovacionin, bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Krahas mësimdhënies, një vend shumë të rëndësishëm zë edhe kërkimi shkencor në përputhje me filozofinë dhe misionin e programit të studimit dhe universitetit, të stafit akademik dhe studentëve, si dhe në përputhje me kapacitetet njerëzore dhe financiare.

Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci” synon të formojë profesionistët e ardhshëm në fushën farmaceutike duke u dhënë njohuri në disa drejtime:

- Njohuri mbi barnat nga pikëpamja e përbërjes së tyre kimike, përgatitjes së formave të shumëllojshme farmaceutike magjistrale si dhe parimet e përgatitjes industriale të këtyre preparateve, mënyrat e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë, efektet e tij në organizëm, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I FARMACISË

- Njohuri mbi barnat nga pikëpamja e veprimit të tyre në organizëm duke filluar nga rrugët e hyrjes, përthithja, shpërndarja, aktiviteti farmakologjik, ndërveprimet e barnave, efektet e padëshiruara, efektet toksike, rrugët e eliminimit, etj.
- Njohuri mbi barnat nga pikëpamja legjislative dhe menaxheriale deri sa arrijnë tek pacienti ku përfshihen kushtet e ruajtjes, promocioni, planifikimi, kontrolli financiar, etj.
- Njohuri mbi drogat bimore mjekësore, produktet natyrore, dietetike e kozmetike.
- Njohuri mbi rëndësinë e komunikimit në mjekësi si dhe të ndërveprimit të shëndetshëm mes profesionistëve të shëndetit.

Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin

Profili i Farmacistit karakterizohet nga njohuri të thelluara në: shkencat kimike bazë, shkencat kimike profesionale të aplikuara, kimizmin e barnave dhe rrugët e sintetizimit të tyre, në shkencat mjekësore të domosdoshme për profesionin, farmakologjinë, farmakokinetikën, farmakognozinë, në teknologjinë e përgatitjes dhe kontrollit të cilësisë së barit, mënyrën e tij të veprimit, administrimin e tij, në aspekte të menaxhimit farmaceutik, njohuri legjislative, aftësi të komunikimit dhe të punuarit në grup etj.

Mundësitë e punësimit

Farmacisti mund të punësohet në të gjitha institucionet farmaceutike publike dhe private ku përfshihen, administrata dhe institucione që përfshijnë menaxhimin e problemeve farmaceutike.

Specifikisht, i diplomuari në programin “Master i Shkencave” në “Farmaci” mund të punësohet në:

- farmaci komunitare;
- farmaci spitalore;
- industri farmaceutike;
- industri bioteknologjike;
- institucione rregullatore dhe administrative;
- AKBPM;
- FSDKSH;
- laboratorë analizash klinike, biokimike, mikrobiologjike dhe toksikologjike;
- laboratorë të kontrollit të cilësisë;
- sektorin e analizës ushqimore;
- sektorin e produkteve natyrore, dietetike dhe kozmetike;
- institucione kërkimore dhe akademike.

Gama e gjerë e punësimit reflekton formimin e plotë akademik dhe profesional që programi ofron në shkencat farmaceutike, kimike dhe mjekësore; fakt ky që pasqyrohet në planin dhe programet mësimore të shkollës sonë.

III. PROGRAMI I STUDIMIT FARMACI - TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Struktura e programit të studimit “Farmaci” organizohet sipas veprimtarive formuese të lëndëve/disiplinave të programit, si më poshtë:

- a. lëndë bazë të programit, si Anatomia, Biologjia, Kimia, Fizikë etj, që zënë 61 ECTS të programit;
- b. lëndë karakterizuese të programit që zënë 163 ECTS të programit;
- c. lëndë integruese që zënë 40 ECTS të programit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I FARMACISË

- d. lëndë plotësuese dhe që zënë 28 ECTS të programit;
- e. teza e diplomës që zë 8 ECTS të programit;

Format e mësimdhënies leksion, seminar, laborator, praktikë lëndore dhe praktikë klinike/profesionale realizohen në një total orësh prej 3233 orë mësimore, nga të cilat:

Programi i studimit Master i Shkencave në “Farmaci”		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	1208,5
b.	Seminare	566,5
c.	Ushtrime / Laboratore	932
d.	Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor	60
e.	Praktikë profesionale	450
f.	Diploma/Provimi Formimi	16
	Në total	3233
	Ngarkesa javore mesatare	21.5

Diplomimi realizohet në përfundim të programit të studimit, kur studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare. Teza e diplomës hartohet dhe mbrohet në përputhje me udhëzuesin specifik të miratuar.

Departamenti i Farmacisë synon përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor përmes:

- rishikimit periodik të syllabuseve;
- përditësimit të literaturës bashkëkohore;
- përdorimit të metodave interaktive të mësimdhënies;
- forcimit të komponentit praktik dhe laboratorik;
- vlerësimit të vazhdueshëm të performancës akademike;
- rritjes së përfshirjes së studentëve në procesin mësimor.

IV. PERSONELI AKADEMIK DHE NDIHMËS AKADEMIK

Personeli akademik për programin e integruar të studimit në Farmaci është përzgjedhur bazuar në fushat specifike akademike dhe në eksperiencat praktike e profesionale të tyre.

Procesi i rekrutimit të personelit akademik bëhet në përputhje me procedurat e miratuara nga UMT-ja për këtë qëllim (identifikimi i nevojave dhe përcaktimi i kriterëve bëhet nga njësia bazë). Shpallja e vendit/ve vakante, afateve të aplikimit, si dhe kriteret përkatëse bëhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore në Buletinën e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Çdo fillim viti akademik, njësia bazë (departamenti) planifikon shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me kualifikimin e stafit dhe me përvojat akademike të tij, si dhe në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I FARMACISË

përputhje me aktet normative për ngarkesën vjetore të stafit, duke mundësuar dhe hapësira për stafin akademik lidhur me angazhimin e tyre në studime, hulumtime shkencore të fushës.

Në vitin akademik 2025-2026 në Departamentin e Farmacisë janë angazhuar në përmbushjen e procesit mësimor 11 (njëmbëdhjetë) pedagogë me kohë të plotë (staf i departamentit), 17 pedagogë me kohë të plotë (staf i departamenteve të tjera të Fakultetit të Mjekësisë), 1 pedagog i ftuar, 26 pedagogë me kohë të pjesshme; nga këta 12 janë pedagogë për Shkencat Bazë Formuese (Module të përbashkëta me programin e studimit Msc Mjekësi). I gjithë stafi akademik i Departamentit të Farmacisë ka grada ose tituj akademikë (3 me titull Prof. Dr. dhe 8 Prof. Asoc.).

Grupet mësimore janë ndarë në përputhje me udhëzimet në fuqi me rreth 20 studentë grupi i laboratorit, 25 grupi i seminareve dhe deri 150 veta grupi i leksioneve. Ora e mësimit realizohet 50 minuta. Ngarkesa mesatare javore e studentit është rreth 20-24 orë javore në përputhje me udhëzimin përkatës.

Ngarkesa mësimore mesatare e personelit akademik me kohë të plotë dhe atij me kontratë është në përputhje me udhëzimin Nr. 29. Dt 10.09.2018, i ndryshuar.

V. INFRASTRUKTURA NË DISPOZICION TË PROGRAMIT

Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, zhvillon aktivitetin akademik dhe procesin mësimor në godinat si më poshtë:

1. Godina kryesore
2. Godina e Lëndëve Paraklinike nr 1
3. Godina e Lëndëve Paraklinike nr 2
4. Godina e Mjekut të Familjes
5. Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik
6. Auditoriumi Galileo- Galilei

Në total:

Nr. Sallave = 14
Nr. Zyra = 78
Nr. Labororëve = 28
Nr. Klasave = 42

Godina e Farmacisë dhe Shëndetit publik përfshin 1 auditor me kapacitet 100 vende uljeje, 5 salla seminari me 30 vende uljeje, 13 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 20 zyra administrative. Referuar vetëm kapaciteteve infrastrukturore që lidhen me mësimdhënien dhe edukimin, aktualisht janë në dispozicion të mësimdhënies dhe mësimnxënies sipërfaqe në m² totalisht konform standardeve si në pronësi të FM-së ashtu edhe të SSHU-së.

Fakulteti i Mjekësisë ka në dispozicion të studentëve dhe ambiente si më poshtë:

1. Palestra sportive (shkolla “Skënder Çaçi”) është në shërbim të studentëve dhe personelit.
2. Biblioteka e FM ku mundësohet edhe akses në internet.
3. Biblioteka qendrore e UMT dhe 6 salla leximi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I FARMACISË

VI. KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE

Fakulteti i Mjekësisë, UMT, çdo vit akademik përcakton kriteret e pranimi të studentëve në programet e studimit që ofron, të cilat pas miratimit nga Senati Akademik i UMT, bëhen publike që në muajin shkurt të vitit përkatës.

Kriteri minimal i pranimi në programin e studimit Msc në Farmaci është nota mesatare e arsimit të mesëm së bashku me provimet e maturës shtetërore (MVKM) ≥ 8.5 .